

VENDIM
Nr.756, datë 9.11.2006

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
110/20 KV, BUSHAT, SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të paurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV, Bushat, Shkodër, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 13 800 m², tokë bujqësore/arë dhe kultura bujqësore, vlerësuar në shumën e përgjithshme 13 991 828 (trembëdhjetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e tetë) lekë.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e KESH sh.a., zëri “Kosto vendore për shpronësimet”.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit të jetë në shumën 316 000 (treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë dhe të përballohet nga KESH sh.a., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit dhejto 2006.

7. Punimet për ndërtimin e këtij nënstacioni kanë filluar në muajin shtator 2006 dhe të përfundojnë brenda vitit 2007.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE "NDERITIMIT TE NENSTACIONIT 110/20 KV BUSHAT, SHKODER"

RRETHI : SHKODER
KOMUNA: BUSHAT
FSHATI : KOSMAÇE

Lloji i pasurise se paluajtshme qe shpronesohet: Toke bujqesore Are
Lloji i pasurise qe demtohet per shkak te nderimit te nenstacionit: Kulturë bujqësore të mbjella (Jonxhë):

Nr	Shpronesimi per pasurine paluajtshme						Kulturat bujqesore te demtuara				Adresa e pronarit				
	Emri	Atësia	Albicmri	Lloji i pasurise	Zona kadastrale	Numri i pasurise	Sasia në m²	Çmimi në lekë/m²	Vlera e kompesimit ne lekë per token	Lloji i kultures bujqesore te demtuar		Sasia në m²	Çmimi në lekë/m²	Vlera e kompesimit ne lekë per kult bujqesore	Vlera Totale e kompesimit
1	Sabri	Eliav	Cerbeti	Toke are	2236	812/14	2638	1000	2.638.000	Jonxhe	2638	14	36.932	2.674.932	Kosmaje
2	Kuftim	Eliav	Cerbeti	Toke are	2236	812/15	2821	1000	2.821.000	Jonxhe	2821	14	39.494	2.860.494	Kosmaje
3	Mustaf Shefik	Latif Mustaf	Cerbeti Cerbeti	Toke are	2236	812/16	8341	1000	8.341.000	Jonxhe	8243	14	115.402	8.456.402	Kosmaje
	Totali						13.800		13.800.000				191.828	13.991.828	

V.O. Te gjithë personat e rreshtit me numer 3 te tabelës, janë bashkepronare ne pasurine qe shpronesohet.

Sqarime : Shpenzime proceduriale: Publikime 246.000 (dyqindedyzetegjashtemijë)lekë.

Shpërblim i anëtarëve të komisonit dhe sekretarise teknike 70.000 (shtatedhjetëmijë) lekë.

